REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Recieved/Delivery | 16 . 10 . 201 8 | | vitit god year |
|---|---|---|---|
| Organi/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit | Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No: | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SHPMSHC | 6037/2018 | | 1/4 |


# Republika e Kosovës
## Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A nr.563/2018**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Hajzer Salihu-kryetar, Eshref Shabani dhe Shkëmb Manaj-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.563/2018 të datës 03.09.2018 e parashtruar nga ankuesi Skender Sylejmani, kundër Vendimit me numër të protokollit 5794 të datës 17.08.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.10.2018, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.563/2018 e datës 03.09.2018, e parashtruar nga ankuesi Skender Sylejmani.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi me numër 5794 i datës 17.08.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

**III.** Vendimi hynë ne fuqi ne ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**A r s y e t i m**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me datë 06.06.2018 ka shpallur konkursin për pozitën "Inspektor i Tregut" në Divizionin për Cilësi dhe Tregtinë e Naftës dhe Derivateve të Naftës, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Skender Sylejmani i cili ka marr pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit, por që pas rezultateve përfundimtare nuk është përzgjedhur. Më datën 05.07.2018 është bërë njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm, ndërsa ankuesi më datë 30.07.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë më datë 17.08.2018 nxjerr Vendimin me numër të protokollit 5794 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër të protokollit 5794 të datës 17.08.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, më datë 03.09.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5013/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.09.2018, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë më datë 11.09.2018 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 03.09.2018 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 17.08.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Ankesa e datës 30.07.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Miratimi nga MAP/DASHC-ja për shpalljen e konkursit të datës 04.06.2018; Konkursi i datës 06.06.2018; Vendimi i datës 06.10.2016 me numër 02Ref.332 i Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimi i datës 16.06.2017 me numër 02 Ref.207 i Sekretarit të Përgjithshëm; Raporti i vlerësimit të zgjedhjes së ngushtë i datës 25.06.2018; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 05.07.2018; Testi me shkrim; Vlerësimi individual i kandidatëve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj (Form.MAP-SHCK-08a); Renditja përfundimtare e kandidatëve (Form.MAP-SHCK-10); Përmbledhja e vlerësimeve individuale (Form.MAP-SHCK-09); E-mail i datës 09.07.2018; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues (Form.MAP-SHCK-11); Kërkesa për punësim e kandidatit Eljesa Beqiri me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim i kandidatit Taulant Krasniqi me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesa për punësim i kandidatit Skender Sylejmani me dokumentacionin e bashkangjitur si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit Skender Sylejmani, ***është e pabazuar, sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankuesit i cili e ka kontestuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe përzgjedhjen e kandidatëve të pranuar sa i përket përvojës së punës dhe njohurive që kanë në fushën e tregtisë së naftës dhe derivateve të naftës, si dhe trajnimet që kanë ndjekur në këtë fushë kandidatët e përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë me datë 22.06.2018 me numër 02/Ref.162 ka themeluar Komisioni Përzgjedhës të Shërbimit civil në pajtim me nenin 7 paragrafit 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil me këtë përbërje:

1. Lulzim Syla-Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut- Kryesues;
2. Nexhmije Shala-Koordinatore e njësisë për të drejtat e njeriut- Anëtare;
3. Astrit Hyseni- Udhëheqës i Divizionit për TI dhe shërbime Logjistike- Anëtarë;
4. Valon Berisha- Zyrtare i Lartë Ligjor-Anëtarë dhe
5. Enver Krasniqi- Inspektor i Mbikëqyrjes së Tregut për Naftë dhe Derivate të Saj- Anëtarë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës të dërguara nga organi i punësimit ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, poentimin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në bazë të nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë që paragrafi 1 i këtij neni përcakton se: ***"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale;"***, dhe në bazë të kësaj Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në listë të ngushtë ka përfshirë edhe ankuesin dhe kandidatët e përzgjedhur sepse i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit të datës 06.06.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, mbi bazë të provave të vlerësuara ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit i cili dyshon se kandidatët e përzgjedhur nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit është i paqëndrueshëm, sepse kriteret e konkursit për pozitën "Inspektor i Tregut" kanë qenë ***"diplomë universitare: FSHMN, Juridik, Ekonomik, ...minimum 3 vite përvojë pune profesionale"***, ndërsa kandidatët e përzgjedhur:

1. Eljesa Beqiri - posedon Diplomën me numër 1852 të datës 11.02.2008 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Ekonomik me të cilën dëshmohet se me datë 03.09.2007 ka mbaruar studimet themelore në Degën Banka dhe Financa dhe merr kualifikimin Ekonomist i Diplomuar, me përvojë të punës si në vijmë: sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Kompanisë Private "DARDANIA 2" sh.p.k. vërtetohet se z. Beqiri nga janari i vitit 2014 gjer në mars të vitit 2018 ka qenë në marrëdhënie pune me këtë kompani në pozitën e "Menaxher i Kontabilitetit" si dhe kandidati
2. Taulant Krasniqi – posedon Diplomën me numër 8550 të datës 16.11.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Ekonomik, me të cilën dëshmohet se me datë 25.07.2014 ka përfunduar studimet në Departamentin Menaxhment dhe Informatikë dhe morri titullin Bachelor për Menaxhment dhe Informatikë, dhe me përvojë pune si në vijmë: sipas Referencës NPT "AL-VIS" me të cilën vërtetohet se nga data 01.01.2014 gjer më 10.05.2017 ka qenë në vendin e punës "Menaxher i Personelit" dhe sipas vërtetimit të lëshuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Personelit i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilën vërtetohet se nga data 13.05-31.12.2017 ka qenë në vendin e punës "Zyrtar i Listës Votuese".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën "Inspektor i Tregut", nuk ka bërë vlerësim të drejtë, sepse vlerësimi i komisionit është bërë në kundërshtim me kriterin numër 3 të përcaktuar me konkursin e datës 06.06.2018 që ka të bëjë me njohurit e thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike të fituara përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse, Kolegji ka konstatuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil gjatë gjithë procedurës së vlerësimit të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ka bërë vlerësim objektiv duke u bazuar në dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar, sepse ankuesi në bazë të Formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve për pozitën "Inspektor i Tregut" ka grumbulluar gjithsejtë 72.15 pikë dhe është renditur i katërti, ndërsa kandidati i përzgjedhur Eljesa Beqiri ka grumbulluar gjithsejtë 87.9 pikë dhe është renditur i pari dhe kandidati i dytë i përzgjedhur Taulant Krasniqi ka grumbulluar gjithsej 85.3 pikë dhe është renditur i dyti andaj Kolegji konstaton se në shërbimin civil emërohen kandidat që kanë numërim më të madh të pikëve, ashtu siç edhe parashihet me nenin 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: ***"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë".***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të të gjitha provave të lëndës, ka konstatuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil procedurën e rekrutimit për pozitën "Inspektor i Tregut" e ka zhvilluar duke u bazuar në dispozitat e nenit 3 paragrafit 9, nenit 11 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L–149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: ***"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës''*** dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 5794 të datës 17.08.2018, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L–149 për Shërbimin Civil të Republikës

së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike**: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

***Vendimi i dërgohet***

- *Ankuesit Skender Sylejmani;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

Arkivit të **Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**
**Lënda me numër A.nr.563/2018;**

**Hajzer Salihu**
**Kryetar i Kolegjit**

**Valentina Kaçandolli Bekteshi**
**Procesmbajtëse**